

## VLERËSIM I SHPEJTË I SITUATËS SË FËMIJËVE TË HUAJ TË PASHOQËRUAR DHE/OSE TË NDARË NË SHQIPËRI

Vlerësimi i shpejtë për fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë u bë në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, ASHDMF, me Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës (NJMF), përfaqësues të policisë së shtetit dhe të Drejtorisë së Kufirit dhe Emigracionit, profesionistë të shërbimit social në Bashkitë Gjirokastrë, Sarandë, Konsipol, Korçë, Devoll, Kukës, me përfaqësues të strukturave të tjera përgjegjëse për azilin ose refugjatët si UNHCR, CARITAS, Qendrat emergjente të pritjes dhe akomodimit në Tiranë, Gjirokastrë, Korçë, me qendrën Nisma ARSIS, etj, të cilët së bashku luajnë rolin kryesor në identifikimin, informimin dhe ofrimin e shërbimeve bazë ligjore, sociale, psikologjike dhe akomoduese për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të pashoqëruar apo të ndarë, të cilët hyjnë në territorin e Shqipërisë.

*Synimet e vlerësimit: a) zbatimi i dispozitave ligjore ekzistuese; b) mënyra e bashkëpunimit ndërmjet organeve shtetërore dhe jo shtetërore të përfshira në trajtimin dhe mbrojtjen e fëmijëve të pashoqëruar apo të ndarë; c) niveli i koordinimit të hallkave dhe mekanizmave që kanë detyrimin dhe bëjnë të funksionojë sistemi i mbrojtjes dhe i shërbimit për këtë kategori;*


**Periudha e vlerësimit**  
Shkurt-Prill, 2023.

### **Mbulimi gjeografik**

Takimet u zhvilluan në Tiranë, Gjirokastrë, Sarandë, Korçë dhe Kukës, me shtrirje në Konispol, Devoll.

### **Profili**

Vlerësimi ka në fokus mbrojtjen e fëmijëve të pashoqëruar të larguar nga vendet në konflikt si Siria, Afganistani, edhe nga vende të tjera si Pakistani, Bangladeshi, Egjipti, Maroku, etj, të cilët hyjnë në territorin e Shqipërisë, përmes vendkalimeve kufitare dhe brezit të gjelbër të Republikës së Shqipërisë me Greqinë.



Fëmijët e pashoqëruar deklarojnë se kalojnë kufirin në Shqipëri për:

- të shpëtuar nga dhuna, konfliktet e armatosura, rreziku i trafikimit, varfëria apo pamundësia financiare për të përballuar jetesën në vendet e tyre;
- për t'u bashkuar me familjarët e tyre në vendet e BE-së
- për të gjetur një jetesë më të mirë dhe më të mbrojtur në këto vende;



### **Gjetje**

-Fëmijët e huaj, të pashoqëruar nga persona të rritur, të identifikuar në territorin e Shqipërisë hyjnë kryesisht në mënyrë jo ligjore, përmes brezit të gjelbër pranë pikave kufitare;

-Identifikimi i fëmijëve të pashoqëruar është bërë në zonat kufitare si Korça, Devolli, Gjirokastrë, Sarandë, Konispol, por dhe në qytete të tjera si Vlorë dhe Tiranë;

-Identifikimi ligjor i fëmijëve, bazuar në të dhënat personale ka qenë i pamundur dhe i vështirë, sepse nuk zotërojnë dokumente identifikimi, përveç ndonjë leje qëndrimi të shtetit grek të falsifikuara ose me të dhëna të pasakta, të bazuara në vetëdeklarimet e tyre;

-Të gjithë personat që konstatohen në territorin shqiptar dhe vetdeklarojnë se janë të mitur të pashoqëruar, prezumohen dhe trajtohen si të tillë;

-Mungon një vlerësim i moshës së fëmijës;

-Fëmijët e pashoqëruar, kudo ku konstatohen në vendkalimin kufitar apo brenda në territorin e Shqipërisë raportohen nga punonjësit e policisë së shtetit, të Departamentit për Kufirin dhe Emigracionin, edhe nga struktura të tjera lokale apo përgjegjëse për azilin ose refugjatët.

-Pas identifikimit dhe pas kryerjes së procedurave nga strukturat e policisë, rasti referohet te punonjësi për mbrojtjen e fëmijës (PMF) brenda 12 orësh, në territorin ku është konstatuar fëmija, i cili informon dhe raporton zyrtarisht dhe në çdo rast, agjencinë shtetërore për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, ASHDMF.

-Procedura e referimit të rastit nga policia kufitare tek PMF funksionon drejtpërdrejtë ose nëpërmjet telefonit.

-Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe PMF së bashku bëjnë një verifikimin të moshës së fëmijës bazuar kryesisht në vetdeklarimin e tij;

-PMF, në bashkëpunim me punonjësit e policisë, në territorin e të cilit ndodhet fëmija, bën vlerësimin fillestar të rastit, nëpërmjet verifikimit të gjeneraliteteve të tij, vendbanimit, shtetësisë, gjendjes konkrete të fëmijës, nevojave që ka për trajtim dhe përgatit një informacion ku përfshihen gjithashtu arsyet e hyrjes dhe të qëndrimit të pashoqëruar në territorin e Republikës së Shqipërisë;

-Ky raport përgatitet brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga momenti i referimit të rastit dhe i dërgohet ASHDMF;

-Më tej PMF ndjek hapat në Gjykatë për caktimin e masës emergjente të mbrojtjes;

-PMF gjatë intervistimit të fëmijëve është kujdesur që gjatë vlerësimit fillestar, fëmijët e pashoqëruar të informohen për të drejtat e tyre ligjore, sociale, sigurojë shërbimin e psikologut dhe përkthyesit. Këto shërbime janë ofruar nga struktura të pranishme në pikat kufitare nga CARITAS, IOM, UNHCR, Frontex, etj;

-Nuk ka një përcaktim apo referim ligjor të qartë për strehimin e menjëhershëm në qendra shtetërore të fëmijëve të pashoqëruar që nuk janë azilkërkuar. Kjo kategori deri tani në pjesën dërrmuese ka refuzuar të qëndrojnë në Shqipëri apo të aplikojnë si azilkërkuar. Vetëm në 1 rast fëmija i pashoqëruar ka kërkuar azil në Shqipëri;

-Janë Qendrat e përkohshme të pritjes si Nisma ARSIS në Tiranë, Qendra e



Përkohshme e Pritjes Gjirokastër, Qendra “Tjetër Vizion” në Elbasan (për fëmijët nën moshën 14 vjeç) që funksionojnë si qendra emergjente të përkohshme të pritjes dhe strehimit të fëmijëve të pashoqëruar. Këto janë Qendra të hapura, ku fëmijët e pashoqëruar mund të dalin dhe të largohen në çdo moment, duke krijuar mundësinë të jenë objekt trafikimi, dhune apo abuzimi.

-Qendra Kombëtare e Pritjes së Azilkërkuesve në Babrru, Tiranë, edhe pse e bollshme në ambiente strehimi dhe jo vetëm, nuk është vënë në dispozicion të fëmijëve të pashoqëruar për shkak të kufizimeve të përcaktuara në legjislacionin aktual në fuqi;

-Bazuar në nenin 43 të Ligjit Nr 10/2021 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”, “Fëmija mund të akomodohet në Qendrën e Pritjes për Azil, në vendin e përcaktuar nga Ministria e Brendshme ose në një vend tjetër sipas dëshirës së fëmijës”. Bazuar në përgjigjen e Ministrisë së Brendshme, aktualisht Qendra e Pritjes për Azil nuk mund të ofrojë shërbim për persona nën 18 vjeç.


-Del se për të gjitha rastet mungon akomodimi (strehimi) në fazën fillestare të fëmijëve të identifikuar, në kohën kur kryhet intervistimi, vlerësimi i nevojave të tyre në pikat kufitare përkatëse deri në momentin e hartimit të raportit të plotë nga PMF-ja për marrjen e masës emergjente të mbrojtjes dhe planin individual të çdo fëmije;

-Në fazën fillestare menjëherë pas identifikimit, ofrohet akomodim deri në 10 ore në konteneret që ndodhen në pikat kufitare që mbulohen me shërbime nga Organizatat humanitare si UNHCR dhe Caritas

-Është fakt që aktualisht gjithë përgjegjësia për trajtimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve të pashoqëruar i mbetet strukturave për mbrojtjen e fëmijës, gjë që për arsye të ndryshme nuk mjafton, prandaj procesi i plotë i menaxhimit reduktohet me fazën e referimit dhe të caktimit të masës emergjente.

-Përsa i përket procedurave të ndjekura për të realizuar ribashkimin e fëmijëve të pashoqëruar me familjarët sipas të dhënave të marra nga qendra Nisma ARSIS, për periudhën 2020- 2023, nga 54 fëmijë të akomoduar në qendrat e përkohshme të shërbimeve emergjente, vetëm 5 prej tyre janë ribashkuar me të afërmit e tyre. Ndërsa 49 fëmijët e tjerë të pashoqëruar janë larguar në drejtim të paditur. Për këtë kategori janë bërë kallëzimet përkatëse pranë drejtorive vendore të policisë dhe janë raportuar në ASHDMF.

-Nuk ka patur raste që fëmijët e pashoqëruar të kenë qenë në konflikt me ligjin dhe nuk është identifikuar asnjë fëmijë me aftësi të kufizuara fizike apo mendore që të kërkojë mbrojtje të veçantë.




Gjatë viteve 2019- mars 2023 janë trajtuar 127 raste të fëmijëve të huaj të pashoqëruar. Fëmijët e identifikuar nga strukturat e intervistuar janë kryesisht nga Afganistani, Siria, Maroku, Egjipti, dhe Bangladeshi. Ata kanë hyrë dhe janë

identifikuar nga pikat kufitare të Devollit, Gjirokastrës, Kukësit, por edhe të gjendur në Vlorë dhe Tiranë.

Shqipërisë” duhet të përfshijë në kategoritë e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror fëmijët e huaj të pashoqëruar.

### Përfundime dhe rekomandime



Nuk është miratuar ende Udhëzimi i Ministrit të MSHMS në përgjigje të pikës 15 të VKM Nr. 111 datë 06.03.2019, për të përcaktuar qendrën e specializuar të shërbimeve të plota akomoduese, ligjore, sociale, psikologjike apo edukative për fëmijët e huaj të pashoqëruar, që identifikohen apo gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Udhëzimi në zbatim aktualisht nuk është miratuar duke e bërë të pamundur përcaktimin e një shërbimi për kategorinë e fëmijëve të huaj të pashoqëruar.

- Duhet të rishikohet kuadri ligjor për të ofruar mbrojtje të veçantë dhe specifike për fëmijët huaj të pashoqëruar, të cilët nuk janë azilkërkues dhe as të identifikuar si viktima trafikimi apo abuzimi.
- Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e

- Hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të veçanta për bashkëpunimin kufitar, veçanërisht me Republikën e Greqisë, me fokus fëmijët e pashoqëruar.

- Duhet të miratohet Udhëzimi i Ministrit përgjegjës për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës përcaktohen institucionet dhe mënyra e ofrimit të shërbimit për fëmijët e huaj të pashoqëruar. Do të ishte më praktike të hartohet një akt nënligjor (nëse do të ishte e mundur) ku të parashikoheshin të gjitha të drejtat dhe garancitë për fëmijët e pashoqëruar.

- Nevoja për të hartuar një udhëzues të përbashkët ndërmjet Ministrit të Shëndetit Publik, Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, i cili do të jetë i dobishëm në përcaktimin e rolit, përgjegjësive dhe detyrave të secilit aktor të përfshirë në këtë proces.

- Duhet të rregullohet ligjërisht statusi i këtyre fëmijëve që duan të kalojnë transit në Shqipëri.

- Lehtësimi i procedurave për pajisjen e fëmijës me një leje të veçantë qëndrimi;

- Në momentin e intervistimit dhe vlerësimit fillestar, PMF dhe Drejtoria e Migracionit duhet të vlerësojnë elementet e rrezikut dhe gjendjes së tyre shëndetësore duke kryer ekzaminim mjeko-ligjor.

- Kjo mund të kërkojë ndërhyrje në ligjet kryesore, si Kodi i Familjes


etj. që mund të sigurojnë procedura të shpejta dhe efektive për fëmijët e pashoqëruar në nevojë për mbrojtje emergjente.

komunitar dhe të evitohet në maksimum centralizmi dhe institucionalizmi i fëmijëve.

- Zbatimi i masës së mbrojtjes mbetet pa përfunduar, pasi shërbimi social shtetëror nuk ofron shërbime për këtë kategori fëmijësh dhe për shkak të mospërcaktimit të kujdestarit ligjor.
- Fëmijët duhet të informohen për te gjitha hapat dhe fazat që do të ndiqen deri në marrjen e masës së vendosjes së në kujdestari ligjor.
  - Shërbimet e strehimit nën masën e përkohshme të mbrojtjes dhe vendosjen në përkujdesje alternative të ofrohen në nivel

- Sugjerohet mbajtja e evidencave më të sakta e të plota, në mënyrë elektronike në një sistem qendror, për çdo fëmijë të huaj të pashoqëruar të asistuar në pikat kufitare dhe çdo hallkë të procedurës së ndjekur.
- Shtimi i buxhetit dhe financimi i shërbimeve, qoftë në nivel vendor dhe atë qendror mbetet sfidë e madhe për përmirësimin e sistemit të shërbimeve që ofrohen ndaj fëmijëve.
- Të planifikohet në vazhdimësi puna për ngritjen e kapaciteteve të personave të përfshirë në menaxhimin e fëmijëve të pashoqëruar

• **Skema aktuale e funksionimit dhe përfshirjes së aktorëve shtetëror dhe jo shtetëror për funksionimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve të pashoqëruar<sup>1</sup> në kuadrin kohor të vlerësimit:**



<sup>1</sup> Me të kuqe tërhiqet vëmendja për boshllëkun që faktikisht është i pa përcaktuar dhe i pakoordinuar për aktorët që shërbejnë;